

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Isa Kelmendi dhe Qerim Ademaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.G. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson i autorizuari V.S., avokat nga Lipjani, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson e autorizuar Sh.G., juriste e të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditëses dhe ankesës së të paditurës të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.60/12, i datës 18.10.2013, në seancën jo publike të mbajtur me datë 20.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PRANOHET pjesërisht ankesa e të autorizuarit të paditëses L.G. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.60/12, i datës 18.10.2013, në pjesën e kërkesëpadsisë lidhur me dëmin material për ndihem dhe kujdesin e personit të tretë dhe për ushqim të përforcuar, ashtu që gjykohet: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” Prishtinë, që paditëses L.G. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, në emër të kompensimit për ndihem dhe kujdesin e personit të tretë ti paguaj shumën prej 110 Euro dhe në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 60 Euro.

II. PRANOHET pjesërisht ankesa e të paditurës, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.60/12, i datës 18.10.2013, në pjesën e kërkesëpadsisë sa i përket kamatës së gjykuar dhe gjykohet: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” Prishtinë, që paditëses për pjesën e aprovuar të kërkesëpadsisë t’ia paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 18.10.2013, e deri në pagesën definitive.

III. REFUZOHEN të pathemelta ankesa e të autorizuarit të paditëses L.G. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.60/12, i datës 18.10.2013, në pjesën tjetër të dispozitivit VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.60/12, i datës 18.10.2013, me pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadsinë e paditëses L.G. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit dhe e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, që për dëmin e shkaktuar paditëses në cilësinë e këmbësore në aksidentin e komunikacionit të datës 18.10.2011 në Lipjan në Rr.”Shën Flori”, me automjetin e tipit VË, me targa të regjistrimit 01-799-BN, t’ia paguajë dhe atë në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike shumën prej 3.000 Euro, në emër të frikës së shkaktuar shumën prej 2.000 Euro, për shpenzimet e shërimit shumën prej 5 Euro.

Me pikën II (dy) të dispozitivit e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë për dëmin jo material dhe atë për dhimbje fizike shumë prej 1.500 Euro, për frikën e shkaktuar shumë prej 1.500 Euro, ndërsa për dëmin material për ndihmë dhe kujdesin e personit të tretë në shumë prej 110 Euro, për ushqim të përforcuar shumë prej 60 Euro dhe për rehabilitim shëndetësor shumë prej 250 Euro si të pabazuara. Me pikën III (tre) të dispozitivit është detyruar e paditura që paditëses t'ia kompensojë dëmin jo material dhe material me kamatë vjetore në lartësi prej 12% në vit nga data e gjykimit 18.10.2013, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 842.80 Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë kanë paraqitur i autorizuari i paditëses dhe e paditura. I autorizuari i paditëses për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë vetëm në pjesën refuzuese të tij ashtu që ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si dhe pjesën e kamatës duke filluar nga dita e ushtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, ndërsa e paditura aktgjykimin e ka atakuar për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovojë si të bazuar ndërsa aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të paditëses dhe ankesa e të paditurës janë pjesërisht të bazuara.

Nga shkresat e lëndës rezultojnë se paditësja L.G. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, përmes të autorizuarit të saj me datë 12.03.2012, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Siguria" me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura t'ia kompensojë dëmin material dhe jo material që i është shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 18.10.2011, në shumë të përgjithshme prej 8.425,00 Euro, me kamatë vjetore në lartësi prej 12% duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë 21.11.2011, e gjer në pagesën definitive si dhe t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore aq sa do të llogariten nga gjykata, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses pas shqyrtimit dhe administrimit të provave nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresat tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.60/12, të datës 18.10.2013, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se me datë 18.10.2011, në Lipjan, në rrugën "Shën Flori" është shkaktuar aksidenti i komunikacionit ku përderisa paditësja në cilësi të këmbësore ishte duke kaluar udhëkryqin për të shkuar në shkollën "Adem Gllavica", pa pritur është goditur nga vetura e tipit VË, e tipit 245, e vitit të prodhimit 1989, me targa të regjistrimit 01-799-BN, të cilin e drejtonte Alban Olluri me ç'rast paditëses i shkaktonte lëndime trupore.

Ka arsyetuar se baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuar nga e paditura por është kontestuar vetëm lartësia e kërkesëpadisë. Në cilësi të provave materiale ka administruar mendimin profesional të ekspertëve Dr.A.F. ortoped-traumatolog dhe Dr.M.K.-psikiatër të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.09.2013, sipas së cilës paditësja L.G. ka pësuar lëndime trupore përdredhje të unazave të qafës, zhvendosje të bërrylit të djathtë dhe kontuzion në gjurin e djathtë si dhe qarje të kokës të radiusit të djathtë të cilat kualifikohen si lëndime të rënda trupore. Lëndimet janë manifestuar me dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 1 ore, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 24 ore, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 10 ditësh dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët janë të pranishme edhe sot kohë pas kohe sidomos gjatë ndryshimit të kohës, frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 2 muajve, e cila është manifestuar me simptome të ankthit të gjeneralizuara, çrregullim të gjumit, rikujtim të herëpashershëm të ngjarjes që nënkupton gjendjen e reaksionit akut ndaj stresit. Frikë të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 1 muaji, e që është manifestuar me reagime emocionale të karakterit ansioz, rënie të vullnetit dhe të koncentrimin, ndjenja e pavlerës dhe e pashpresës si dhe frikë e pasiguri në pjesëmarrje në komunikacion. Frika e intensitetit të ulët është manifestuar me pasiguri në pjesëmarrje në komunikacion. Sipas vlerësimit të ekspertëve paditësja ka pasur nevojë për ndihmë dhe kujdes të huaj në kohëzgjatje prej 15 ditësh, për shkak të mbajtjes së qafës dhe imobilizimit me gips në dorën e djathtë, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 10 ditë, i përbërë prej proteinav, vitaminav e mineralev, ndërsa rehabilitimi ka qenë i nevojshëm për 10 ditë. Sa i përket lartësisë së kompensimit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se e njëjta është caktuar duke marrë për bazë lartësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim.

Lidhur me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se paditësja me asnjë provë nuk e ka vërtetuar besueshmërinë e kërkesës me çka ka rezultuar që e njëjta të refuzohet. Për bazë juridike gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 154, 178 dhe 200 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur konform dispozitës së nenit 452 paragrafi 1 dhe 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të t'paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, rrjedhimisht edhe i përmbarueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës për vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se në seancën shqyrtimit kryeso të datës 18.10.2013, e paditura e ka kontestuar vetëm lartësinë e kërkesëpadisë, madje paditëses edhe i ka bërë ofertë për mbylljen e kontestit me pajtim gjyqësor.

Edhe sikur të ishte kontestuar bazë juridike nga ana e të paditurës një pretendim i tillë ankimor nuk do të pranohej sepse në procedurën e provave gjykata e shkallë së parë ka administruara ekspertizën e komunikacionit dhe aktgjykimin penal mbi kontributin dhe përgjegjësin e të siguruarit të e paditura për të cilat prova nuk janë paraqitur vërejtje. Në këtë kontekst nuk qëndron pretendimi i të paditurës se gjykata nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike me qenë se e paditura nuk ka paraqitur vërejtje në ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti Msc.ing.Leonora Krasniqi, sipas të cilës rezulton se aksidenti është shkaktuar me kontributin e të siguruarit të e paditura, gjë që konfirmohet edhe nga aktgjykimi penal me të cilin është shpallur përgjegjës i siguruarit të e paditura.

Gjykata e Apelit, i ka pranuar në tërësi konstatimet e gjykatës se shkallë së parë përkitazi me gjendjen faktike, mirëpo në pjesën e ndryshuar të aktgjykimit ka gjetur se drejta materiale është aplikuar gabimisht.

Për pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar për dëmin material dhe për kamatën, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Për pjesën e ndryshuar të aktgjykimit përkitazi me dëmin material për ndihmën e personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar, Gjykata e Apelit, vendosi të ndryshoj aktgjykimin në këtë pjesë sepse nevojën për ndihmën e personit të tretë dhe për ushqimin e përforcuar e kanë konstatuar ekspertet mjekësor, ndërsa shumica e aprovuar për këto dy kategori të dëmit material është brenda limiteve të pranuar nga praktika gjyqësore për shkak se ndihmë e nevojshme dhe ushqimin e përforcuar paditësja e ka marr nga familja e saj për çka nuk mund të ofroj provë materiale.

Aktgjykimi është ndryshuar edhe sa i përket kamatës sepse gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën tre të dispozitivit të këtij aktgjykimi e duke iu referuar nenit 277 të LMD-së.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me dëmin jo material për dhimbjet fizike dhe për frikën Gjykata e Apelit, vlerësoj se gjykata e shkallë së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këto kategori të dëmit në atë mënyrë që shumat e gjykuara janë në ekuivalencë më të mirën e shkelur/cenuar, duke siguruar që kompensimit të shërbej si satisfacion për paditësen. Gjykata ka pas në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben ky kompensim dhe është kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfacion për të dëmtuarën. Mbi këtë bazë gjykata duke e pasur parasysh natyrën e lëndimeve të rënda që ka pësuar paditësja, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika, si dhe rrethanat tjera si moshën e paditëses dhe praktiken e mirë gjyqësore për këto lloje të dëmit ka nxjerr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Për dëmin material lidhur me rehabilitim dhe për shpenzimet e shërimit gjykata ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme pasi që kërkesëpadia e aprovuar në shumë prej 5 Euro për shpenzimet e shërimit dhe kërkesëpadia e refuzuar në shumë prej 250 Euro për tretmanin fizikal janë kategori të dëmit material që mbështeten sa i prekte vlerës në provat material që ofron pala.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhej më veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpengimeve dhe në pajtim me dispozita e LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e) e lidhur 201 pika (d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr. 3942/13, me datë 20.02.2017

Kryetari i kolegjit
Albert Zogaj, d.v